



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:219747
Datë: 03.09.2024
Numri i dokumentit: 06115431

PAKR.nr.187/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.H., nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani dhe av.Korab Bokshi, dhe të akuzuarit E.H., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2020, të dt.19.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani dhe av.Korab Bokshi, dhe të akuzuarit E.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2020, të dt.19.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2020, të dt.19.01.2024, është shpallur fajtor i akuzuari E.H., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është detyruar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 200 (dyqind) Euro, si dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) Euro, gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Është urdhëruar i akuzuari që palës së dëmtuar, t'i kompensoi shumen e parave prej 10 (dhjete) Euro, ndërsa për pjesën e dëmit tjetër të pësuar material dhe jo material, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-i akuzuari E.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i njëjti të lirohet nga akuza,

-mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, ashtu që të akuzuarin ta liron nga akuza, ose eventualisht ta pushoj procedurën për shkak të parashkrimit në ekzekutim ose çështjen penale ta anulon dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që Gjykata e Apelit, ta ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.3 të KPPK, të merr aktgjykim me të cilin të refuzohet akuza ose në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, të akuzuarin ta liroj nga akuza, në mungesë të provave.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresat PPA/I.nr.176/2024, të datave, 21.03.2024, 28.03.2024, dhe 03.04.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara nga ana, e mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani dhe av.Korab Bokshi, dhe të akuzuarit E.H., ka propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.173/2020, të dt.19.01.2024, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.04.07.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari E.H., dhe mbrojtësi i tij, av.Korab Bokshi, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, i dëmtuari N.S., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit av.Nexhat Elshani, edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se në këtë çështje penale, aktakuza e prokurorit të shtetit është dashur të hedhet poshtë, ngase hetimet ndaj të akuzuarit kanë zgjatur më shumë se tetë vite, kurs lidhur me këtë prokuroria arsyetohet me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve në vitin 2018. Gjithashtu në këtë çështje penale në shkresat e lëndës kemi vetëm provat që i bie në barrë ndërkaq në anën tjetër aktgjykimi bazohet vetëm në deklarinimin e palës së dëmtuar.

I akuzuari E.H., deklaron se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së tij, av.Korab Bokshi, dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani dhe av.Korab Bokshi, dhe të akuzuarit E.H., aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani dhe av.Korab Bokshi, dhe të akuzuarit E.H., nuk janë të bazuara

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 pika 2.3, 2.5, dhe 2.7 dhe lidhur me nenin 369 par.6,7 dhe 8 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit nuk është i qartë, nuk është i kuptueshëm, dhe nuk është mbështetur në të gjitha veprimet procedurale, të cilat i ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë. Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave të KPK, andaj gjykata duhet të veproj në kuptim të nenit 403 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të KPPK, për të mbështetur aktgjykimin në të gjitha provat materiale. Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari E., është kryes i veprës penale të kryer me dt.08.02.2011, mirëpo, me asnjë provë nuk është arrestuar veprimi i kundërligjshëm i këtu të akuzuarit. Në këtë çështje penale, rezulton se hetimet kanë zgjatur më shumë se tetë vite, sepse nga parashtrimi i kallëzimit penal me dt.17.05.2012, gjerë në ngritje të aktakuzë se me dt.25.09.2019, janë shkelur të gjitha afatet ligjore që nënkupton se hetimi në këtë çështje penale është tej zgjatur. Po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se janë përdorur varësisht prej kontestit kohor tri loje të kodeve të procedurës penale, që nënkupton se këtu kemi me shkelje të dispozitave ligjore, ngase edhe praktika gjyqësore nuk lejon që kallëzimi penal, të ushtrohet pas tetë viteve, e më pastaj të nxjerrët aktvendimi për fillimin e hetimeve. Të gjitha këto shkelje e bëjnë aktgjykimin e pa qartë dhe të pa kuptueshëm, e po ashtu edhe me rastin e nxjerrjes së provave personale, përkatësisht deklarinimit të dëmtuarve lidhur me identifikimin e të akuzuarit, gjatë shqyrtimit gjyqësor është shkelur procedura e identifikimit edhe pse e njëjta është paraparë shumë qartë me dispozitat përkatëse ligjore.

Edhe sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, av.Nexhat Elshani, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar që i akuzuari E.H., ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, se aktakuza nuk ka qenë e përpiluar në harmoni me ligjin, andaj në këtë drejtim jemi të bindur se kolegji i Gjykatës së Apelit, do të kujdeset për të gjitha shkeljet esenciale edhe sipas detyrës zyrtare.

I akuzuari E.H., ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se pasi që aktgjykimi përfshihet me shkeljet e shumta, si i tillë është i pa qëndrueshëm, andaj gjykata e shkallës së parë duhet të kujdeset për shkelje të cilat janë bërë me aktgjykim, ngase është detyrë edhe zyrtarisht të përkujdeset për të njëjtat.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi dhe av.Nexhat Elshani, e po ashtu edhe sipas ankesës së të akuzuarit E.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në dispozitën ligjore nga neni 384 të KPPK, për të cilat shkeljet përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK. Kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale ankesat e ushtruar përkritazi me shkeljet esenciale nuk janë të bazuara. Nga shkresat e lëndës rezulton se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe arsyetimin e dhënë për çdo pikë të aktgjykimit, ngase në aktgjykim janë të përfshira të gjitha faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje, nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK. Kjo rezulton pasi që kolegji i kësaj gjykate vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe ka ardhur në përfundim se në mënyrë të qartë janë vlerësuar të gjitha provat, sikurse ato personale po ashtu edhe ato materiale, ngase nga e njëjta gjykatë është respektuar në përpikëri dispozita ligjore nga neni 384 e KPPK.

Nga vlerësimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se janë respektuar të gjitha paragrafët e dispozitës ligjore nga neni 384 të KPPK, duke vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale, për të cilat është akuzuar i akuzuari E.H., se aktgjykimi është bazuar në vlerësimin e të gjitha formave sikurse atyre personale, po ashtu edhe atyre materiale, e po ashtu kolegji i kësaj gjykate vije në përfundim se në këtë çështje penale, aktgjykimi është përpiluar konform përmbajtjes dhe formës së aktgjykimit të kërkuar me shkrim, ngase i njëjti përfshin të gjitha pikat përkatësisht të gjitha pjesët e një aktgjykimi, sikurse është pjesa hyrëse, dispozitivi dhe arsyetimi. Po ashtu kolegji me vëmendje ka vlerësuar se çdo pikë në aktgjykim është arsyetuar me të gjitha provat të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe se gjykata ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të saktë se cilat fakte konsiderohen të vërtetuara që në rastin konkret kanë vërtetuar të gjitha elementet inkriminuese të veprës penale. Gjithashtu, është ardhur në përfundim që gjykata e shkallës së parë, ka vendosur për të gjitha propozimet e ngritura, dhe ka marrë vendim të duhur për të vërtetuar vërtetimin apo mos vërtetimin e veprës penale, si dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, që në këtë çështje hetimet kanë zgjatur mbi tetë vite, janë të sakta, mirëpo me dispozitën ligjor në fuqi, të paraparë në KPPK, prej nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve e gjerë në ngritjen e aktakuzës është evident afati kohor prej dy vite, plus gjashtë muaj, që në rastin konkret rezulton se ngritja e aktakuzës ka qenë brenda afatit kohor të paraparë dhe në këtë drejtim aktakuza përmban dispozitat përkatëse ligjore në fuqi.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike, që nënkupton se në këtë çështje penale përkundër asaj që ka pasur prova të mjaftueshme, për të vërtetuar apo mos vërtetuar, ekzistimin e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, dhe gjykata e shkallës së parë ka lënduar dispozitat procedurale, duke kërkuar që të bëjë identifikimin e drejtpërdrejt të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke shkelur dispozitat ligjore, nga neni 120 i KPPK, përkatësisht nenit 116 të KPPK.

Procedura e identifikimit sipas kësaj dispozite ligjore është fare mirë e përcaktuar dhe e paraparë, ashtu që një shkelje e tillë është e pa kalueshme, sepse nuk është respektuar e njëjta dispozitë ligjore, ashtu që edhe në këtë drejtim pasi që identifikimi është bërë i kundërligjshëm, nuk janë vlerësuar edhe të gjitha provat personale dhe materiale, përkundër asaj që kanë qenë të bollshme për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale, e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Po ashtu lidhur me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, ankesë ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av.Nexhat Elshani, duke theksuar se nuk janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale, përkundër asaj që provat nga shkresat e lëndës, kanë qenë të bollshme, andaj me një vlerësim sa më adekuat të të njëjtëve, ka mundur që të vërtetohet gjendja faktike, kurse në rastin konkret jemi të bindur se pasi që nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, atëherë edhe është dashur të nxirret aktgjykim lirues.

Po të njëjtin pretendim ankimor, e hasim edhe në ankesën e të akuzuarit E.H., pa dhënë ndonjë arsytim se pse e njëjta është ushtruar, mirëpo i akuzuari pretendon se në këtë çështje penale nuk ka ardhur në shprehjet parimi “indubio pro reo”, përkitazi në mëdysheje në ekzistimin e veprës penale, andaj të gjitha provat të cilat janë proceduar qojnë në drejtim të të akuzuarit dhe vërtetojnë se i njëjti nuk ka kryer veprën penale, andaj edhe është dashur që të nxjerrët aktgjykim lirues.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pretendimet ankimore, nga ana e mbrojtësve së të akuzuarit, si dhe ankesës së të akuzuarit, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale pasi që janë vlerësuar të gjitha provat personale dhe ato materiale, në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK.

Kolegji po ashtu ka vërtetuar se me të gjitha provat të cilat janë proceduar dhe vlerësuar është vërtetuar se me dt.08.02.2011, rreth orës 23:15minutar në rrugën magjistrale Prishtinë – Fushë Kosovë, në pompën e benzinës “Kosova Petroll”, i akuzuari në bashkëpunim me personin NN, e me qëllim që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë grabitur të dëmtuarin N.S.n, të cilit i kanë shkaktuar lëndime trupore, në atë mënyrë që i akuzuari E., derisa është ndaluar te pompa e benzinës, për të mbushur me derivate veturën e tij të markës “Pezho”, ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit 438-KS-218, e derisa i dëmtuari ka qenë duke punuar në mbushjen e rezervarit të veturës me derivate, i akuzuari ka nxjerr revolen, dhe i kërkon të holla të dëmtuarit, e më pastaj ia fut duart në xhepa, dhe pas kontrollimit ia gjen 10 Euro, të cilat ia merr, gjuan dy herë me revole për të shkaktuar panik tek i dëmtuari dhe të njëjtin e godet me kondak të revoles në kokë dy herë, duke i shkaktuar lëndime trupore, ashtu që kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga vetë deklarata e të dëmtuarit N.S., i cili ka bërë përshkrimin e rastit të ndodhur ditën kritike. Për lëndimet të cilat i ka pësuar i dëmtuari, pasi që është goditur me kondak të revoles, i njëjti është alivanosur, dhe gjetur nga ana e policisë të cilët kanë ardhur në vendin e ngjarjes menjëherë pas

rastit të kryer dhe është dërguar për mjekim në spital, kurse sa i përket revoles së përdorur e njëjta pasi që i është nënshtruar ekzaminimeve, është vërtetuar se përgjigjet me gëzhojën e cila është gjetur në vendin e ngjarjes, epo ashtu pas ekzaminimeve më përmbajtësore, është vërtetuar se e njëjta revole është përdorur edhe në rastin kur është vra tani i ndjeri F.H.. Po ashtu i dëmtuari N.S., ka deklaruar se në këtë çështje penale vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit, është kryer vepra penale e cila i vihet në barrë dhe se e ka njohur pësonin i cili e ka sulmuar natën kritike, duke theksuar se ky është E.H., i cili natën kritike kur ka shkuar në pompën e benzinës kinse me marrë derivate e ka sulmuar të njëjtin, duke i meshua me kondak të revoles për të cilat lëndime të cilat i ka pësuar edhe ka shkuar në QKUK, të cilin veprim e mbështet raporti i QKUK, i dt.09.02.2011. Po ashtu dhe nga deklarata e policit hetues Muhamet Muja, është vërtetuar se personi i cili e ka sulmuar dhe i ka shkakuar lëndime trupore të dëmtuarit është E.H., duke u vërtetuar kjo deklaratë edhe nga deklarata e dëshmitarit H.D., i cili në mënyrë të qartë edhe bënë përshkrimin e rastit të ndodhur.

Përkundër asaj që i akuzuari E.H., mundohet që ti shmanget përgjegjësisë penalo juridike, i njëjti nuk ka arritur që të ikë përgjegjësisë, sepse vet ka dëshmuar se me automjetin e markës “Pezho”, ka shkuar për tu furnizuar me derivate, ashtu që këtë situatë të ndodhur e ka vërtetuar edhe policia hetuese, e sidomos pas ekzaminimeve të duhura, përkitazi me raportin e balistikës, foto dokumentacioni nga shkresat e lëndës dhe tiketën e shqiptuar të dt.23.02.2011, në emër të E.H.t, për veturën “Pezho”, foto dokumentacioni dhe raportet mjekësore nga të cilat vërtetohet se lëndimet trupore ia ka shkakuar E.H., këtu të dëmtuarin N.S., si dhe raportet policore që ndërliken me rastin e ndodhur.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të bindshme ka vërtetuar se në këtë çështje penale vepra penale e kryer nga ana e këtu të akuzuarit E.H., është kryer me dt.08.02.2011, dhe vazhdimisht ka qenë në mbledhje të provave për të vërtetuar veprimet inkriminuese të akuzuarit E.H., përkundër asaj që i njëjti mundohet që ti ikë përgjegjësisë penalo juridike, por nuk arrin, andaj pasi që provat personale, si dhe provat materiale të cilat kanë relacione të afërta në mes veti, dhe pas vlerësimit të tyre vërtetohet se i akuzuari E.H., ka kryer veprën penale të grabitjes si bashkë kryes, nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK, për të cilën edhe e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Nga ankesat e ushtruara nga ana e mbrojtësve së të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi, dhe av.Nexhat Elshani, si dhe ankesa e të akuzuarit E.H., rezulton se aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke mos dhënë ndonjë arsytim lidhur me këtë bazë ankimore më të thuktë, kolegji ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me këtë bazë ankimore dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në nenin 385 të KPPK, sepse ka vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të bindur se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar të gjitha elementet qenësore të veprës penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale dhe ardhur në përfundim se i akuzuari si bashkëkryerës me personin NN, e ka kryer të njëjtën, që nënkupton se edhe instituti i bashkëkryerjes është vërtetuar. Po ashtu kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk eksitojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale sepse provat e shumta në këtë çështje penale, vërtetojnë në mënyrë të pa dyshimtë se është kryer vepra penale e cila i vihet në barrë të

akuzuarit, për çka edhe drejt është vepruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, kur i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi përkatës ligjor. Gjithashtu nga shkresat e ëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore dhe ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Edhe për shkak të vendimit për dënimin, mbrojtësit e të akuzuarit E.H., av.Korab Bokshi dhe av.Nexhat Elshani, si dhe i akuzuari E.H., kanë ushtruar ankesë, ashtu që kolegji i kësaj gjykate i ka vlerësuar të njëjtat dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë është përkuqdesur që pasi që ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, e duke pasur parasysh rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, ka vlerësuar si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, se është dëmtuar personi i cili ka qenë në kryerjen e detyrave të punës, në orë të natës, e po ashtu ka pasur parasysh se i akuzuari E.H., edhe më parë ka qenë i dënuar me aktgjykimin me nr.PKR.46/2016, i plotfuqishëm me dt.28.02.2017, për veprën penale të vrasjes, po ashtu ka vlerësuar edhe rrethana lehtësuese se i akuzuari është mbajtës i familjes, se në kohën kur ka kryer veprën penale, ka qenë relativisht i ri, se ka kaluar kohë e gjatë prej kohës së kryerjes së veprës penale, se i akuzuari tani është kthyer në familje, kolegji vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale, e as me shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë, e cila rezulton nga shkresat e lëndës.

Nga ankesat e ushtruara, kolegji ka ardhur në përfundim se nuk ka ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, ashtu që në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 34 të KPK.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.187/2024, të datës 04.07.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani